



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 48
Prishtinë, më 10.12.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Valentina Bunjaku–Rexhepi, Abdyl Salihu, Driton Çausi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj–Halimaj.

Munguan: Fidan Rekalii, Verica Çeraniq dhe Nezir Çoçaj.

Përfaqësues tjerë: Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT, KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i komisionit: Shaip Goxhuli dhe Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.12.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-135 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen me propozimin për plotësimin e rendit të ditës me një pikë shtesë, me shqyrtimin e *Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Anëtarët e komisionit miratuan rendin e ditës, me propozimin për plotësimin e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.12.2018

Procesverbali i mbledhjes së datës 3.12.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-135 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi, tha se Projektligji për Arsimin e Lartë është i mirëpritur dhe shpreson se i njëjti, pa pengesa, do të miratohet në parim dhe pastaj në fazën e amendamentimit, do të bëhen plotësimet e nevojshme. Andaj, ftoi ministrin e Arsimit, z. Shyqiri Bytyçi, që ta prezantojë projektligjin.

Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT, tha se në Projektligjin për Arsimin e Lartë janë bërë disa ndryshime dhe në krahasim me ligjin, i cili është aktualisht në fuqi, ky projektligj është mjaft modern. Ai tha se qëllimet kryesore të ndryshimeve që janë bërë në projektligj, kanë të bëjnë me modernizimin dhe qeverisjen në institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë që të ngrihet cilësia e arsimit, janë bërë kufizime në ngritjen e cilësisë së arsimit në institucionet që kanë të drejtë të prodhojnë profesionistë të arsimit dhe kjo kompetencë do t'u kalohet vetëm institucioneve publike. Projektligji me rishikimet e bëra, përcakton format sesi mund ta fitojë statusin, si një institucion i lartë, objektivat që ka secili institucion, ku duhet përmbushur për të marrë një licencë, procedurat që kolegjet private të kenë statuse që nuk do të kenë qëllime përfitimi, ka ardhur si ndihmesë nga Bashkësia Evropiane.

Driton Çausi, përmendi disa vërejtje që kanë të bëjnë me nene të caktuara në tekstin e projektligjit. Ai tha se neni 8, pika 2.2, që ka të bëjë me statusin e universiteteve, është në kundërshtim me nenin 8, pika 2.3, i cili ua njeh statusin e universitetit të gjitha institucioneve të themeluara e të cilat nuk plotësojnë kriteret për të qenë universitete. Sipas tij, universitetet publike kanë probleme të mëdha. Ai tha se në Universitetin e Prizrenit, është një numër i vogël i stafit akademik, në krahasim me numrin e madh të studentëve që ka.

Në vazhdim, përmendi vërejtjet e tij lidhur me nenin 18, që ka të bëjë me autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, neni 22, që ka të bëjë me këshillin drejtues, konkretisht emërimin e anëtarëve të jashtëm nga ministri, që konsideron se është ndërhyrje në autonominë e këshillit drejtues, si dhe neni 33, që ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e studentëve, e që sipas tij, është në kundërshtim me nenin 6, pika 1 të këtij projektligji. Në vazhdim, tha se përkrah idenë që arsimit i lartë të jetë pa pagesë.

Teuta Haxhiu, tha se përmes këtij projektligji duhet të përcaktohen qartë procedurat e licencimit të institucioneve të arsimit të lartë, emërimet e bartësve publikë dhe privatë të arsimit të lartë. Po ashtu, tha se duhet organizuar disa dëgjime publike, në mënyrë që palët e interesit të kenë mundësi të japin kontributin e tyre. Ajo tha se projektligj duhet të ketë sa më pak akte nënligjore, sepse këto po krijojnë një huti dhe ligjet që nuk po përgatiten mirë, po përmbajnë shumë akte nënligjore. Po ashtu, e konsideroi si një projektligj mjaft të rëndësishëm, por sipas

saj, projektligji duhet t'i marrë të gjitha votat, përfshirë edhe votat e komunitetit serb, të cilët së fundi herë nuk e kishin votuar pro.

Mufëra Shinik, tha se Projektligji për Arsimin e Lartë është një rëndësie të veçantë. Por, sipas saj, në tekstin e projektligjit nuk ka vërejtur se ka dispozita, të cilat përcaktojnë që komunitetet jo-shumicë të kenë provimin pranues në gjuhën e tyre. Kërkoj që ministria të angazhohet në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, nga ana e bartësve publikë dhe privatë të arsimit të lartë.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, paraqiti vërejtjet në nenin 14, lidhur me akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe nenin 17, lidhur me bashkimin, ndarjen apo mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë. Ajo tha se jam për ruajtjen e universiteteve publike, që janë aktualisht dhe të kontribuohet më tepër në staf dhe në infrastrukturë, në këtë institucione. Më tej, tha se Universiteti "Kadri Zeka" pranon studentë të shumtë edhe nga rajoni dhe se ka nevojë për të investuar në infrastrukturë, pasi që ka pak hapësirë dhe se duhet të bëhet ndërtimi i kampusit universitar.

Arbërie Nagavci, tha se projektligji ka mjaft çështje që janë konfuze njëra me tjetrën, ku përmendi nenin 7, që ka të bëjë me kornizën e kualifikimeve dhe ciklet e organizimit të arsimit të lartë, që sipas saj, duhet rishikuar dhe qartësuar. Më tej, përmendi vërejtjet e saj në kapitullin IV, pika 6, që ka të bëjë me nxjerrjen e aktit nënligjorë për përcaktimin e formatit të përmbajtjes së gradave akademike dhe diplomave, kapitullin VI, që ka të bëjë me strukturat qeverisëse të arsimit të lartë, kapitullin VII, që ka të bëjë me kushtet e përgjithshme për punësim të personelit në institucione të arsimit të lartë.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, me qëllim të përcaktimit të rregullave bazë për organizimin e arsimit të lartë. Ajo kërkoj sqarim nga ministri se gjatë hartimit të projektligjit, a kanë qenë të përfshirë bartësit privatë të arsimit të lartë dhe se cilat janë opinionet e tyre lidhur e propozimin që bartësit privatë të arsimit të lartë, të jenë institucione joprofitabile.

Abdyl Salihu, tha se në parim e mbështet projektligjin, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka dhe do ta japë kontributin, gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit në mes dy leximeve.

Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT, tha se projektligji ka ende nevojë të ndryshohet dhe se mirëpret të gjitha sugjerimet dhe komentet e anëtarëve të komisionit, që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë. Më tej, tha se statusi i universiteteve publike ka nevojë të rishikohen dhe të analizohen se cilat universitete e meritojnë të quhen universitete. Pagesat për studentët janë pak dhe janë simbolike. Ajo nuk është pagesë e një semestri që po e kryen, por për punën që po bëhet dhe nuk bie ndesh me të drejtën e edukimit të lartë dhe pagesën. Po ashtu, tha se të gjitha palët e interesit kanë qenë të përfshira në procesin e hartimit të projektligjit dhe kanë pasur mundësi të japin komentet e tyre, ndërsa bartësit privatë nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje, sa i përket propozimit për statusin e tyre joprofitabil.

Pas diskutimeve, anëtarët e komisionit, me 7 vota për, 1 abstenim, miratuan Projektligjin nr.06/L-135 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.06/L-135 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

4. Projektligjin 06/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ismajl Kurteshi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia dha ministrit të Arsimit Shyqiri Bytyçi.

Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT, lidhur me Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, tha se kjo marrëveshje është e rëndësishme së veçantë për studentët kosovarë, meqë Ambasada e Francës ka shprehur gatishmëri që studentët tanë në universitetet e Francës, të ndjekin dy nivele të studimeve Master, ndërsa financimi i bursave do të bëhet bashkërisht nga MASHT dhe Agjencia "Campus France".

Anëtarët e komisionit, me shumicë votash, miratuan Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligji nr.06/L-139 për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve Master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

5. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, propozoi që në emër të komisionit, të reagojnë me një shkresë në UNESKO, në bashkëpunim me Këshillin për Trashëgimi dhe Ministrinë e Kulturës, lidhur me regjistrimin e veglës muzikore të shqiptarëve, "Lahutës", të cilën serbët e kanë regjistruar atje, si vegël të tyre, e cila, sipas tij, përbën shkelje dhe padrejtësi. Sipas tij, për letrën që do t'ia dërgojnë UNESKO-s, paraprakisht do të duhet të konsultohen për informata shtesë me Departamentin për Trashëgimi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në mënyrë që ajo të jetë sa më përmbajtjesore dhe me argumente.

Propozimi u përkrah njëzëri nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi